

## **AKT THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME "BURSA E TIRANES" SH.A**

Me cilesine e pronarit ne emer te shtetit ne baze te ligjit Nr. 8831, date 22.11.2001 "Per pronesine shtetore te shoqerive tregtare financiare me kapital teresisht shtetror" dhe te nenit 36 te Ligjit Nr. 8745, date 22.2.2001 "Per disa shtesa ne ligjin Nr. 8080, date 1.3.1996 "per letrat me vlere vendosa te themelojme shoqerine anonime "Bursa e Tiranes" sipas parashikimeve te ketij akti themelimi dhe statutit bashkangjitur. Per kete arsye ne vendosa sa me poshte:

1. Te themelojme shoqerine anonime me emrin "Bursa e Tiranes" sh.a.
2. Ne te gjitha aktet qe do te nxjerre shoqeria kundrejtuar te treteve si dhe ne gjitha akte e brendeshme te saj do te shenohet detyrimisht emri "Bursa e Tiranes" Sh.a dhe shuma e kapitalit themeltar te saj.

Objekti i veprimtarise se Burses se Tiranes sha eshte krijimi i je tregu kapitalesh apo letrash me vlere duke krijuar nje sistem tregtimi me ane te te cilit

- d) oferta per shitje, blerje apo kembim te letrave me vlere kryhen apo pranohen regullisht;
- e) oferta apo kerkesat kryhen rregullisht, kur jane oferta apo kerkesa te paracktuara, apo jane te priteshme, qe rezultojne drejtperdrejt apo terthorazi ne berjen apo pranimin e ofertave per shitje, blerje apo kembim te letrave me vlere, ose
- f) jepet informacion rregullisht lidhur me cmimet dhe shperblimet qe persona apo grupe te vecanta propozjne apo presin, te shesin, te blejne apo te kembejne letra me vlere.

3. Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne adresen Bulevardi Deshmoret e Kombit, prane ministrise se Financave. Selia e shoqerise mund te ndryshoje ne peruthje me rregullat e vendosura nga Asambleja per kete qellim ne statutin e saj.

4. Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 20 milion leke.

Ai eshte i ndare ne 20.000 (njezetemije) aksione nominative te themeluesve te shoqerise te cilet jane te se njejtës kategori me vlere nominale prej 1.000 (njemije) leke per çdo aksion.

Aksionet jane te numertuara nga 1 deri ne 20.000 perfshire numrin e fundit te aksionit.

6. Organet drejtuese te shoqerise jane:

Keshilli Mbikqyres,

- Drejtori i Pergjthshem.

7. Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga tre vete, te cilet jane caktuar si me poshte nga mbledhja themeluese e shoqerise:

- |                    |         |
|--------------------|---------|
| ⇒ Ahmet Mancellari | Kryetar |
| ⇒ Mitro Çela       | Anetar  |
| ⇒ Genc Çifligu     | Anetar. |

8. Afati i ushtrimit te veprimtarise se ketij keshilli eshte sipas stautit te shoqerise.

9. Drejtor i Pergjithshem i shoqerise i caktuar ne mbledhjen e pare themeluese te saj do te jete zoti Enea Janko.

10. Afati i ushtrimit te funksioneve te tij dhe kompetencat e tij jane sipas stautit te shoqerise.

11. Organizimi dhe funksionimi i shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saj do te perbehen ne peruthje me dispozitat e statutit.

12. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar duke filluar nga momenti i marrjes se licenses per ushtrim veprimtarie nga Komisoni i Letrave me Vlere

13. Dispozita me te hollesishme per shoqerine caktohen ne statutin e saj.

**AKSIONERI  
ANASTAS ANGJELI  
MINISTER I FINANCEVE**

